



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 222 Prot

Peshkopi, më 24.06.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.35


Datë: 20.06.2024

“Për përmisimin e shërbimeve dhe rritjen e mirëqënies sociale për fëmijët me AK në Dibër”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi





BASHKISIA E QARKUT DIBËR
Nr. 2228/1
Mbarimi Di 25.04.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.508/1 prot.

Peshkopi, më 25.06.2024

Lënda: Për vendimin nr.35, datë 20.06.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.35, datë 20.06.2024 “*Për përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e mirëqënies sociale për fëmijët me AK në Dibër*”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 35 Datë 20/06/2024

“ Për përmisimin e shërbimeve dhe rritjen e mirëqënies sociale për fëmijët me AK në Dibër”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Përvetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe Planin Social 2024-2027 të miratuar nga Bashkia Dibër, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **20.06.2024** me 17 vota pro, 0 kundër dhe 3 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Përmisimi i shërbimeve dhe rritja e mirëqënies sociale për fëmijët me AK në Dibër” të financuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me një vlerë 4.515.000 lekë.
2. Bazuar në draft marrëveshjen e projektit si dhe komunikimet periodike me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 90% e vlerës (4.515.000) lekë, të projektit do të financohet nga Ministria dhe 10% e vlerës (451.500) lekë do të financohet nga Bashkia Dibër.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Sektori i Prokurimeve, Bashkia Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **20.06.2024**.

Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak
Mario FEJZA

